



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes : 71041-01028-11-2020
Numri i Vendimit: 11-2020-2593

Data e Regjistrimit : 15/05/2020
Data e Vendimit : 22/06/2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Besjana Garxenaj
SEKRETARE: Anxhela Zotkaj

Sot më datë 22/06/2020mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues Shoqeria R SH

Objekti:-Zhvletësimin e sekuestros vendosur me vendimin e dates 06.05.2020 ora 14.00 te Prokurorise

prane Gjykates se shkallës se pare Durrës, për sasinë e 1 215 701 litra GZ i ngjyrosur, që i perket ankuesit ,shoqerise "R 7" -Detyrimin e paleve te interesuara ,Deges së Doganes Durrës dhe shoqerine EP ,te lejojne ankuesin të tërheqë sasinë e mallit të bllokuar që mbahet nën ruajtje nga shoqeria "EP"&

Baza Ligjore:Nenet 300,301 e vijues të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra nënshtruar rregullave të gjykimit dhe

dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, të cilët kërkuan:

Kërkuesi: *“Heqjen e sekuestros pasi sasia e mallit të bllokuar s’ka asnjë lidhje me veprën penale për të cilën po kryhen hetime.*

Veprimtaria e shoqërisë është kryer në përputhje me ligjin. S’ka pasur asnjëherë penalitete administrative dhe nga organet shtetërore nuk

është konstatuar asnjë lloj parregullsie. Licenca e revokuar nuk është përdorur asnjëherë nga shoqëria “R 7” sh.p.k. Kërkojmë pranimin e kërkesës”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës: *“Rrëzimin e kërkesës pasi ka një procedim penal të regjistruar dhe çështja*

është në hetim. Gjithashtu, ka dyshime se subjekti ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin, duke tregtuar lëndë djegëse në kundërshtim

me licencën e dhënë, pas revokimit të saj. Nga provat e marra rezulton se për periudhën 14.02.2020-04.05.2020 kjo shoqëri ka shitur

sasinë 1,299,950 litra. Nga praktika doganore, rezulton se shoqëria “R 7” sh.a ka zhdoganuar një sasi lëndë ngjyruese karburanti

me vlerë 20,610 euro”.

VEREN :

Fa q j a l n g a 4

Vëren: **Ë R E N:**

I. Procedura dhe Rrethanat e faktit

1. Kërkuesi ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkesën me objekt “Zhvleftësimin e sekuestros të vendosur me vendimin datë 06.05.2020, ora 14.00 të Prokurorisë pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për sasinë prej 1,215,701 litra G, të shoqërisë “R 7” sh.a. Detyrimin e palëve të interesuara, Degës e Doganës Durrës dhe shoqërinë EP, të lejojnë ankuesin të tërheqë sasinë e mallit të bllokuar që mbahet nën ruajtje shoqëria “EP”.

2. **Në këtë gjykim rezultoi e provuar se:** Shoqëria “R 7” sh.a, me NUIS L91419503A është themeluar më datë 13.02.2019, me objekt veprimtarie: *“Tregtim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të hidrokarbureve, naftës, gazit, nënprodukteve të tjera, vajra, lubrifikante,*

import eksport dhe tregtia me shumicë e tyre. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar i tyre etj”.

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr.806, datë 06.05.2020, për veprën penale *“Fshehja e të ardhurave”*, parashikuar nga neni 180/2 i K.Penal. Nga ana e policisë gjyqësore, më datë 05.05.2020 është sekuestruar sasia diesel prej 1,215,701 litra, të kërkuesit “R 7” sh.a, ndodhur në ambientet e subjektit “EU, Tanku nr.6, sipas Procesverbalit për sekuestrimin e provave materiale. Sekuestro e vendosur është vleftësuar me vendimin datë 06.05.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

4. Shoqëria “R 7” sh.a është pajisur me: **1)** Licencë *“Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë me qira”* Nr. LN-7845-07-2019, me afat 19.07.2019- pa afat; **2)** Licencë *“Tregtim*

me shumicë i G kateg III/A”, nr.LN-8067-08-2019, me afat 01.08.2019- pa afat, na Ministria e Financave dhe Ekonomisë; **3)** Licencë *“Furnizim me karburant për konsum, të anijeve në porte dhe rada”*, Nr. LN-9001-10-2019, me afat 15.10.2019-14.10.2024, me Vendim të Ministrisë së Infrastrukturës

dhe Energjitikës; **4)** si dhe është pajisur me Autorizim për kryerjen e procesit të ngjyrimit, Nr.13851/7

Prot, datë 08.08.2019, nga Dega e Doganës Durrës.

5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, me Vendimin nr.85, datë 13.02.2020 ka vendosur të revokojë Licencën *“Furnizim me karburant për konsum, të anijeve në porte dhe rada”*, Nr. LN-9001-10-

2019, dhënë në favor të subjektit “R 7” sh.a. Ndërkohë Dega e Doganës Durrës, me aktin Administrativ nr.5101/2 prot, datë 13.05.2020 ka miratuar: *“Anulimin/Revokimin e Autorizimit për kryerjen e Procesit të Ngjyrimit, të Lëshuar nga Dega e Doganës Durrës, me nr.13851/7 prot, datë 08.08.2019, për shoqërinë “R 7” sh.a, me NIPT L91419503A.*

6. Nga Fatura tatimore e shitjes nr.55667, datë 29.04.2020 rezulton se kërkuesi në këtë gjykim ka blerë nga shoqëria EU Durrës Albania sh.a, sasinë prej 1,215,701 litra G.

7. Nga shkresa nr.5441/1Prot, datë 20.05.2020 e Degës së Doganës Durrës, rezulton se kjo degë nuk ka kryer asnjë praktikë me Vendimin nr.85, datë 13.02.2020, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Tiranë *“Për revokimin e licencës me nr.LC-4272-10-2019, për ushtrimin e*

veprimtarisë së furnizimit me karburant për konsum të anijeve në port të llojit “A”, në të gjitha portet e

Republikës së Shqipërisë”. Ndërsa nga shkresa nr. 8171/1 prot, datë 26.05.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton se referuar të dhënave në sistem C@TS, të datës 21.05.2020, nuk rezultojnë praktika kontrolli nga ana e administratës tatimore, në subjektin “R 7” sh.a, me NIPT L91419503A.

II. Vlerësimi i Gjykatës.

8. Në nenin 208 të K.Pr.Penale, është parashikuar se: *“Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e*

provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2.

Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. 3. Kopja e vendimit të

sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit”. Në nenin 300 të K.Pr.Penale gjendet ky parashikim:

“Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore

marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e

sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë. 2.

Kur ka rrezik që gjurmët dhe

Faqja 2 nga 4

sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë. 2.

Kur ka rrezik që gjurmët dhe

sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë

veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën

penale”. Ndërsa në nenin 301 të K.Pr.Penale përcaktohet: “Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal

shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më

vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja. 2. Prokurori, brenda

dyzet e tetë orëve të ardhshme,

me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të

sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të

cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe

mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato.

Ankimi nuk pezullon

zbatimin e sekuestron”.

9. Nga interpretimi i dispozitave të cituara më lart, Gjykata çmon se sekuestrimi përbën një mjet për kërkimin e provës. Vendimi i

sekuestrimit mund të merret nga gjykata dhe prokuroria, si dhe mund të kryhet me iniciativë nga policia gjyqësore, veprim ky që duhet të

vleftësohet më pas nga prokuroria, brenda afatit ligjor. Është pikërisht qëllimi për sekuestrimin e provave që dallon këtë institut, nga

sekuestroja preventive dhe ajo konservative, të parashikuar nga ligji procedural si masa sigurimi pasuror.

10. Në respektim të procesit të rregullt ligjor është e rëndësishme, që në arsyetimin e vendimit të gjykatës ose të prokurorit që procedon

me vendimin për sekuestrimin, të evidentohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar marrëdhënia e sendit objekt sekuestrimi dhe veprës

penale për të cilën procedohet, duke përcaktuar në çdo rast nëse kemi të bëjmë me një send që përbën provë materiale për veprën për të

cilën po procedohet, apo një send që ka lidhje me veprën penale për të cilën po procedohet.

11. Duke iu rikthyer çështjes objekt gjykimi, rezultoi në këtë gjykim se: Prokuroria pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr.806, datë 06.05.2020, për veprën penale

“Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/2 i K.Penal. Nga ana e policisë gjyqësore, më datë

05.05.2020 është sekuestruar sasia diesel, prej 1,215,701 litra, të kërkuesit “R 7” sh.a , ndodhur në ambientet e subjektit “EU, Tanku nr.6, sipas Procesverbalit për sekuestrimin e provave materiale. Sekuestro e vendosur është vleftësuar me vendimin datë 06.05.2020 të Prokurorisë

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

12. U provua gjithashtu se Shoqëria “R 7” sh.a është pajisur me: **1)** Licencë “Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë me qira” Nr. LN-7845-07-2019, me afat 19.07.2019- pa afat; **2)** Licencë “Tregtim me shumicë i G kateg III/A”, nr.LN-8067-08-2019, me afat 01.08.2019- pa afat, na

Ministria e Financave dhe Ekonomisë; **3)** Licencë “Furnizim me karburant për konsum, të anijeve në

porte dhe rada”, Nr. LN-9001-10-2019, me afat 15.10.2019-14.10.2024, me Vendim të Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Energjitikës; **4)** si dhe është pajisur me Autorizim për kryerjen e procesit të ngjyrimit,

Nr.13851/7 Prot, datë 08.08.2019, nga Dega e Doganës Durrës.

13. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, me Vendimin nr.85, datë 13.02.2020 ka vendosur të revokojë Licencën “Furnizim me karburant për konsum, të anijeve në porte dhe rada”, Nr. LN-9001-10-

2019, dhënë në favor të subjektit “R 7” sh.a. Ndërkohë dega e Doganës Durrës, me aktin Administrativ nr.5101/2 prot, datë 13.05.2020 ka miratuar: “Anullimin/Revokimin e Autorizimit për kryerjen e Proceseit të Ngjyrimit, të Lëshuar nga Dega e Doganës Durrës, me nr.13851/7 prot, datë 08.08.2019, për shoqërinë “R 7” sh.a, me NIPT L91419503A. Ndërkohë, nga Fatura tatimore e shitjes nr.55667, datë 29.04.2020 rezulton se kërkuesi në këtë gjykim ka blerë nga shoqëria EU Durrës Albania sh.a, sasinë prej 1,215,701 litra G.

14. Gjykata vlerëson se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në vendimin datë 06.05.2020, për vleftësimin e sekuestros, ka arsyetuar mbi dyshimin e arsyeshëm të ekzistencës së veprës penale “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/2 i K.Penal si dhe mbi nevojën e sekuestrimit të sasisë prej 1,215,701 litra diesel, si send që ka lidhje me veprën penale Gjykata konstaton se vendimi është marrë brenda afatit ligjor, 48 orë, përcaktuar në nenin 301/2 të K.Pr.Penale.

15. Nga provat e paraqitura nga organi i akuzës, Gjykatës iu krijua bindja se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, duke theksuar se në këtë fazë të hetimeve, **ky dyshim nuk duhet të jetë ezaurues, por mjafton që të duket e mundshme ekzistenca**

e veprës. Nga ana tjetër gjykata çmon se sendi i sekuestruar ka lidhje me veprën penale.

F a q j a 3 n g a 4

16. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me ligjin dhe në bazë të licencave që shoqëria “R 7” sh.a disponon, të lëshuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Gjykata thekson se këto pretendime, për sa kohë ka një procedim penal të regjistruar, do ti

nënshtrohen hetimit të plotë dhe të gjithanshëm, në kuadër të tij.

17. Për sa i përket kërkimit të dytë të paraqitur në kërkesë, për *detyrimin e Degës e Doganës Durrës dhe shoqërinë EP, të lejojnë ankuesin të tërheqë sasinë e mallit të bllokuar që mbahet nën*

ruajtje shoqëria “EP”, gjykata vlerëson se shoqëria “R 7” sh.a, me këto palë, duhet të zgjidhe mosmarrëveshjen nëpërmjet procesit gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Durrës ose Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (seksioni civil), duke iu drejtuar gjykatës me padi. Ky kërkim nuk

mund të shqyrtohet nga kjo gjykatë, për shkak të kompetencës lëndore.

18. Sa më sipër, Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga shoqëria “R 7” sh.a duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova dhe ligj.

Për këto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata, në zbatim të neneve 208, 212 dhe 300 e 301 të K.P.Penale

VENDOSI:

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës penale Nr.(71041-01028) 259, datë regjistrimi 18.05.2020, me kërkesë shoqëria “R 7” sh.a, si të pabazuar në ligj e prova.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes.

U shpall, sot në Durrës, më datë 22.06.2020.

..

SHPENZIMET GJYQËSORE

Kërkesëpadia 0

Taksa Gjyqësore 0

Noterizime 0

Njoftime 0

Akt ekspertimi 0

Avokat 0

Gjithsej 0

GJYQTAR:

Besjana Garxenaj

Faqja 4 nga 4